



Prishtinë, 28 janar 2016
Kodi i ZRRE-së: V_761_2016

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 2.16 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 14 paragrafi 6 dhe 7 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V-559-2013 të datës 06 shtator 2013 për shoqërinë “Era Energji” SH.P.K., se ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit, dhe
- Kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit, të datës 18.09.2015, të shoqërisë “Era Energji” SH.P.K., me adresë “H.Dynan C15-H 3/9 – Prishtinës, Republika e Kosovës,

në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_559_2013 i datës 06 shtator 2013, i lëshuar shoqërisë “Era Energji” SH.P.K., edhe për një afat gjashtë (6) mujor, gjegjësisht **deri me 06 mars 2016**.

A r s y e t i m


- o ZRRE, me datë 18.09.2015 nga shoqëria “Era Energji” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, Komuna e Drenasit.
- o ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Era, me datë 06 shtator 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V_559_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t’i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
- o Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- o Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, është lëshuar në afat (2) dy vjeçar, dhe në këtë vendim është përcaktuar se shoqëria “Era Energji” SH.P.K., do t’i jepet Autorizimi për ndërtim, nëse brenda këtij afati do të bëjë një kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në Autorizim duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.





- Shoqëria “Era Energji” SH.P.K., ka parashtruar kërkesën për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar dhe në kërkesën e saj ka sqaruar se: janë në proces të aktiviteteve biznese, duke pasur parasysh që edhe mbulimi i investimeve të energjisë alternative respektivisht i gjeneratorëve të erës janë shumë të shtrenjta dhe duhet kohë që të arrihet mbulimi i investimeve në realizimin e projektit. Gjithashtu ka sqaruar se të gjitha institucionet relevante që merren me promovimin dhe përkrahjen e investitorëve kanë bërë thirrje se politikat dhe legjislacioni do të jenë në favor të investitorëve, andaj kemi kërkuar që të na vazhdohet afati s’paku edhe për gjashtë (6) muaj i Vendimit mbi njoftimin për autorizimin preliminar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në mënyrë që të vazhdojmë me kompletimin e dëshmive dhe realizimin e projektit në tërësi.
 - ZRRE pas analizimit të kërkesës për shlyerje të afatit të vlefshmërisë të Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, ka vlerësuar ato dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Shoqëria “Era Energji” SH.P.K., brenda këtij afati duhet të bëjë kërkesë me shkrim për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin Preliminar në për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga Era, në lokacionin WindPark - Krajkova, me kapacitet të instaluar prej 21 MW, komuna e Drenasit, gjegjësisht deri me datën **06 mars 2016** duke i plotësuar të gjitha kushtet e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja dhe legjislacionin në fuqi.
- III. Pas skadimit të afatit të cekur më lartë, Vendimi V-559-2013 i datës 06 shtator 2013 mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, do të shfuqizohet në mënyrë automatike, dhe nuk do të shqyrtohet nga Bordi i ZRRE-së.
- IV. Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Enver Halimi, kryesues


Krenar Bujupi, anëtar


Arsim Janova, anëtar


Qemajl Mustafa, anëtar


Besim Sejfiqaj, anëtar